**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**
**Nr.01/060/01-8114/26 datë: 21.04.2026**

**Npi – 01/74 datë: 30.04.2026**

Bazuar në nenet 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenet 34 dhe 40 të Statutit të Komunës së Shtimes, Nr.01-06/1636 të datës 03.09.2008; Nenet 3, 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e themelimit përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë; Dhe sipas kërkesës së MAPL-së Nr-020-210/12 të datës 07.04.2026 për Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/35 të datës 05.03.2026 për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete. Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 30.04.2026 miratoi:

# V E N D I M

## PËR RIZGJEDHJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE SIPAS KËRKESËS SË MAPL-së

I

**Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më datën: 30.04.2026, me shumicën e votave miratoi Vendimin për rizgjedhjen e Komitetit për Komunitete në këtë përbërje:**

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Përfaqësimi i Komunitetit |
|---|---|---|
| 1 | Artan Lubovci | Anëtar i KPK nga Kuvendi |
| 2 | Fatlinda Rrafshi | Anëtare e KPK nga Kuvendi |
| 3 | Haqif Arifi | Anëtar i KPK nga Kuvendi |
| 4 | Gyltene Osmani-Ilazi | Anëtare e KPK nga komuniteti Ashkali |
| 5 | Sabrie Veliu | Anëtare e KPK nga komuniteti Ashkali |
| 6 | Rrahman Kadrija | Anëtar i KPK nga komuniteti Ashkali |
| 7 | Arton Demiri | Anëtar i KPK nga komuniteti Rom |

II

Vendimi i parë i Kuvendit për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete, Npi – 01/35 i datës: 05.03.2026, anulohet.

III

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komitetit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE
SHTIME-ŠTIMLJE
V.V.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi